

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **Trepça SH.A**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **2026/12997 12998-26-1205-1-2-1/B05-0004051**

Sa i përket tenderit për: **Furnizim me rrypa trapezor**

### 1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

**GETNO L.L.C**

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

**Rr.Imzot Nik Prelaj**

(Adresa)

Prishtinë

10,000.00

(Vendi)

(Kodi postar)

+38349676772

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

**Etnik Çitaku**

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

[getnollc@gmail.com](mailto:getnollc@gmail.com)

(Adresa elektronike)

28.05.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Me datën 13.03.2026, AK **Trepca SH.A.** ka publikuar Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me rrypa trapezor”, me Nr. të prokurimit: 2026/12997 12998-26-1205-1-2-1/B05-0004051. Afati i dorëzimit të ofertave ishte **03.04.2026**, ora 13:00.

Vlera paraprake e aktivitetit ishte **17,000.00 €**.

Me datën **14.05.2026**, AK ka publikuar **Njoftimin mbi Vendimin e AK**, ku është propozuar për shpërblym të kontratës Operatori Ekonomik **Adem Deliu B.I, Fahri Aliu, 40000, Mitrovicë** për kundër faktit që i njëjti nuk ka dorëzuar oferte të përgjegjshme.

Me datë 18.05.2026 kemi parashtruar Kerkese për rishqyrtim pranë AK.

Me datë 19.05.2026 AK ka refuzuar Kerkesen për rishqyrtim.

#### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Ne rregull sipas kohës së parashikuar për hapjen e ofertave

#### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

#### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Ne përputhje me nenin 108/a të LPP kemi parashtruar Kërkesë për rishqyrtim brenda

*afateve kohore, respektivisht me date 18.05.2026. Me date 19.05.2026 AK ka nxjerr Vendimin për refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim.*

**AK nuk ka trajtuar asnjë nga pretendimet tona të paraqitura**, por vetëm ka mbajtur qëndrimin e dhënë më parë nëpërmjet letërs standarde, pa dhënë arsytim të veçantë për secilin pretendim.

## **7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

### ***Dispozitat e shkeluara të LPP-së***

1. Neni 1 i LPP – Qellimi
2. Neni 6 i LPP - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
3. Neni 7 i LPP - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
4. Neni 10 i LPP - Mjetet për promovimin e Transparencës
5. Neni 59 i LPP - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
6. Neni 60 i LPP- Kriteret për Dhënien e Kontratës
7. Neni 72 i LPP - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

### ***Dispozitat e shkeluara të Rregullores Nr.002/2024 për Plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik***

8. Neni 40 i RPP - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
9. Neni 61.3 i RPP - Pezullimi i aktivitetit të prokurimit
10. Neni 63.2 i RPP - Vendimi i Autoritetit Kontraktues

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## **8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

GETNO L.L.C. parashtron këtë ankesë bazuar në **dispoziata e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP)**.

Kjo ankesë parashtrohet kundër Vendimit të AK, respektivisht publikimit të **B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK**, i publikuar më datë **14.05.2026**, në lidhje me aktivitetin: “në lidhje me aktivitetin e prokurimit: **“Furnizim me rrypa trapezor”**, me Nr. të prokurimit: **2026/12997 12998-26-1205-1-2-1/B05-0004051**, i publikuar më 13.03.2026, me vlerë të parashikuar

**17,000.00 €.**

Më poshtë paraqesim argumentet tona ligjore në lidhje me shkeljet e kryera nga Komisioni i Vlerësimit i AK-së gjatë këtij aktiviteti të prokurimit.

### **Pretendimi 1 – Shkelja e Neni 59 (Ekzaminimi dhe Vlerësimi i Tenderëve**

Neni 59.4 i Ligjit për Prokurimin Publik përcakton se *një tender konsiderohet i përgjegjshëm vetëm nëse është në përputhje me të gjitha kërkesat e parashtruara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit, ndërsa lejon devijime vetëm në rastet kur ato janë të vogla dhe nuk ndikojnë në aspektet materiale të tenderit.*

Në rastin konkret, OE i propozuar për shpërblim të kontratës nuk ka arritur të dëshmojë përmbushjen e një kërkesë thelbësore të Dosjes së Tenderit, konkretisht kërkesën lidhur me certifikimin ISO 9001:2015 të prodhuesit të mallrave të ofruara.

Në Dosjen e Tenderit është kërkuar shprehimisht: **“Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se prodhuesi i mallrave të ofruara plotëson kushtet e kualitetit sipas standardit ISO 9001:2015.”**

Për të përmbushur këtë kërkesë, OE Adem Deliu B.I. ka dorëzuar një certifikatë ISO 9001:2015 në emër të kompanisë GUFERO Rubber Production s.r.o. (Czech Republic). Mirëpo, nga analiza e përmbajtjes së kësaj certifikate rezulton qartë se ajo nuk mbështet dhe nuk dëshmon faktin se kompania në fjalë është prodhues i mallrave të ofruara.

Fushëveprimi i certifikatës është i kufizuar në aktivitetet:

- purchasing (blerje),
- stocking (magazinim),
- distribution (shpërndarje).

Pra, vetë certifikata dëshmon se kompania ushtron aktivitet tregtar/distributiv dhe jo aktivitet prodhues. Në asnjë pjesë të certifikatës nuk evidentohet procesi i prodhimit, fabrikimit apo manufakturës së produkteve të ofruara, siç është kërkuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit.

Për më tepër, Autoriteti Kontraktues nuk ka të drejtë që gjatë fazës së vlerësimit të interpretojë në mënyrë të zgjeruar ose të relativizojë kërkesat e Dosjes së Tenderit. Kërkesa ka qenë e qartë dhe specifike: **certifikimi ISO 9001:2015 duhet të dëshmojë prodhuesin e mallrave të ofruara, e jo distributorin apo ndërmjetësin tregtar.**

Rrjedhimisht, OE i propozuar për kontratë nuk ka përmbushur një kriter material dhe obligativ të Dosjes së Tenderit. Pranimi i një certifikate që nuk dëshmon aktivitet prodhues përbën trajtim jo të barabartë të operatorëve ekonomikë neni 7 i LPP-se dhe vlerësim në kundërshtim me Nenin 59 të LPP-së. Andaj, konsiderojmë se oferta e OE të propozuar është e papërgjegjshme.

### **Pretendimi 2 – Shkelja e kërkesave të Dosjes së Tenderit dhe Nenit 59 të LPP-së**

Sipas kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, të gjitha dëshmitë dhe dokumentet që vërtetojnë përmbushjen e kritereve kualifikuese duhet të jenë valide dhe të dorëzohen brenda

afatit të përcaktuar për dorëzimin e ofertave.

Në rastin konkret, OE i propozuar për shpërblim të kontratës ka dorëzuar certifikatën **ISO 9001:2015 me afat vlefshmërie deri më 08.04.2026**. Kjo nënkupton se në fazën e vlerësimit, certifikata ka qenë e skaduar dhe pa vlefshmëri juridike.

Rrjedhimisht, një dokument i skaduar nuk mund të konsiderohet si dëshmi valide për përmbushjen e kërkesave të Dosjes së Tenderit. Autoriteti Kontraktues nuk ka të drejtë të pranojë dokumente të pavlefshme apo të skaduara për të konstatuar përmbushjen e kriterëve kualifikuese, pasi një veprim i tillë bie ndesh me parimet e barazisë, trajtimit të drejtë dhe transparencës në prokurim publik.

Për më tepër, mungesa e një certifikate valide ISO 9001:2015 përbën mungesë materiale dhe jo devijim të vogël administrativ. Për këtë arsye, oferta e OE të propozuar është e papërgjegjshme në kuptim të Nenit 59 të LPP-së dhe e njëjta është dashur të eliminohet nga procedura e mëtejme e vlerësimit. Pranimi nga Autoriteti Kontraktues i një certifikate të skaduar përbën vlerësim të kundërligjshëm dhe favorizim të operatorit ekonomik të propozuar për kontratë, në kundërshtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe dispozitat e LPP-së.

### **Pretendimi 3 – Shkelje e Nenit 60 (Kriteret për Dhënien e Kontratës)**

Neni 60.1.1 i Ligjit për Prokurimin Publik përcakton qartë se kontrata publike duhet t'i jepet operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Ky nen obligon Autoritetin Kontraktues që gjatë procesit të vlerësimit dhe dhënies së kontratës të mbështetet vetëm në tenderët që i plotësojnë në tërësi kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe dispozitat ligjore në fuqi.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar për dhënie kontrate një operator ekonomik oferta e të cilit është e papërgjegjshme, për shkak të mosplotësimin të kërkesës materiale lidhur me certifikimin ISO 9001:2015 të prodhuesit të mallrave të ofruara, siç është elaboruar në Pretendimin 1.

Për rrjedhojë, oferta e OE të propozuar nuk ka mundur të konsiderohet ofertë e përgjegjshme në kuptim të Nenit 59 të LPP-së dhe si e tillë nuk ka mundur të merret për bazë për dhënie kontrate sipas Nenit 60 të LPP-së.

Veprimi i Autoritetit Kontraktues për të rekomanduar një operator ekonomik që nuk i plotëson kriteret obligative të Dosjes së Tenderit përbën shkelje të drejtpërdrejtë të Nenit 60 të LPP-së, si dhe cenon parimet themelore të trajtimit të barabartë, transparencës dhe konkurrencës së drejtë në procedurat e prokurimit publik.

### **Pretendimi 4 – Mospërputhja e ofertës me specifikimet teknike të Dosjes së Tenderit (shkelje materiale e Nenit 59 të LPP-së)**

Në Dosjen e Tenderit janë përcaktuar saktësisht specifikimet teknike për artikujt si vijon:

- Pozicioni B4 (katalog nr. 14): Rrypa trapezor TR 32x6850
- Pozicioni B5 (katalog nr. 15): Rrypa trapezor TR 17x2500 (i dhëmbëzuar)
- Pozicioni B6 (katalog nr. 16): Rrypa trapezor TR 32x6850


Këto specifikime janë kërkesa obligative dhe përbëjnë elemente thelbësore të përshkrimit teknik të kontratës, të cilat nuk mund të ndryshohen, zëvendësohen apo interpretohen në mënyrë të zgjeruar gjatë fazës së vlerësimit.

Gjatë shqyrtimit të ofertës së dorëzuar nga OE Adem Deliu B.I., janë konstatuar mospërputhje materiale dhe të qarta me kërkesat e Dosjes së Tenderit, si vijon:

- Për artikullin Rrypa trapezor TR 32x6850, është ofruar Rrypa trapezor TR 32x6900 (katalog nr. 14)
- Për artikullin Rrypa trapezor TR 17x2500 (i dhëmbëzuar), është ofruar Rrypa trapezor TR 17x2440 (katalog nr. 15)
- Për artikullin Rrypa trapezor TR 32x6850, është ofruar Rrypa trapezor TR 32x6825 (katalog nr. 16)

## Deshmite:


### Kërkesa ne Aneksin 1




| nr. | Përshkrimi   | Sasia | Njësia |
|-----|--|-------|--------|
| A   | Rrypa trapezor-Miniera me Flotacion –Kizhnice dhe Artanë |       |        |
| 1   | Rrypa trapezor Tr 17x2240                                | 100   | copë   |
| 2   | Rrypa trapezor Tr 17x2600                                | 100   | copë   |
| 3   | Rrypa trapezor Tr 17x2800                                | 20    | copë   |
| 4   | Rrypa trapezor Tr 32x6850                                | 20    | copë   |
| 5   | Rrypa trapezor Tr 17x2500 ( i dhëmbëzuar)                | 10    | copë   |
| 6   | Rrypa trapezor Tr 32x 6850                               | 10    | copë   |
| 7   | Rrypa trapezor Tr 22 x 2800                              | 50    | copë   |
| 8   | Rrypa trapezor Tr 17 x 2100                              | 5     | copë   |
| 9   | Rrypa trapezor Tr 22x4100                                | 5     | copë   |
| 10  | Rrypa trapezor Tr 17x2000                                | 25    | copë   |
| 11  | Rrypa trapezor Tr 17x2100                                | 10    | copë   |
| 12  | Rrypa trapezor Tr 13x1150                                | 10    | copë   |
| 13  | Rrypa trapezor Tr 13x 1000                               | 10    | copë   |

## Deshmite nga katalogu


### Pozicioni nr.14



## Pozizioni nr.15



## Pozizioni nr.16



**Këto dallime nuk përbëjnë devijime të vogla teknike,** por ndryshime të qarta në dimensione dhe specifitime të produktit, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në funksionalitetin, kompatibilitetin dhe përdorshmërinë e mallrave të kërkuara.

Në përputhje me Nenin 59 të LPP-së, çdo ofertë që nuk i përmbush saktësisht kërkesat teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit konsiderohet ofertë e papërgjegjshme dhe nuk mund të merret për bazë për vlerësim të mëtejshëm apo dhënie të kontratës.

Autoriteti Kontraktues nuk ka të drejtë të pranojë produkte me dimensione të ndryshme nga ato të kërkuara, pasi një veprim i tillë cenon parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe ndryshon në mënyrë materiale objektin e kontratës.

Rrjedhimisht, oferta e OE të propozuar nuk është në përputhje me specifikimet teknike të Dosjes së Tenderit dhe si e tillë është e papërgjegjshme në kuptim të Nenit 59 të LPP-së, duke qenë e domosdoshme eliminimi i saj nga procedura e vlerësimit.

### **Pretendimi 5 – Mungesë e dokumenteve (shkelje e transparencës dhe integritetit të ofertës)**


Në procedurat e prokurimit elektronik, Formulari i dorëzimit të ofertës përfaqëson listën zyrtare të dokumenteve të ngarkuara nga operatori ekonomik në platformë në momentin e dorëzimit të ofertës. Ky formular është pjesë integrale e ofertës dhe shërben si evidencë për gjurmueshmërinë, plotësinë dhe integritetin e dokumentacionit të dorëzuar brenda afatit ligjor të ofertimit.

**Në listën zyrtare të gjeneruar automatikisht nga sistemi elektronik i prokurimit figurojnë vetëm dokumentet si vijon:**

1. Certifikata e biznesit
2. Certifikata e numrit fiskal

3. Certifikata e TVSH-së
4. Deklarata nën betim / përshkrimi i çmimit
5. Deklarata e afatit të liferimit
6. Deklarata e specifikimeve teknike
7. Sigurimi i tenderit

## Deshmi



Gjatë shqyrtimit të ofertës së dorëzuar nga OE Adem Deliu B.I., është konstatuar se **Certifikata ISO 9001:2015 dhe katalogu i produkteve nuk figurojnë fare në Formularin e dorëzimit të ofertës**, pra nuk janë të regjistruara si dokumente të ngarkuara në platformë në momentin e dorëzimit të ofertës.

Ky fakt është thelbësor, pasi nënkupton se:

- këto dokumente nuk janë pjesë e listës zyrtare të gjeneruar nga sistemi në momentin e dorëzimit të ofertës,
- nuk kanë gjurmë të verifikueshme si dokumente të dorëzuara brenda afatit, dhe
- nuk mund të konfirmohet në mënyrë të sigurt koha dhe mënyra e ngarkimit të tyre në sistem.

**Mungesa e ISO certifikatës dhe katalogut në Formularin e dorëzimit të ofertës krijon dyshime serioze mbi integritetin e dokumentacionit dhe cenon parimet themelore të prokurimit publik, në veçanti:**

- parimin e transparencës,
- parimin e gjurmueshmërisë së ofertës, dhe
- parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.


Për më tepër, nëse katalogu është dorëzuar në formë fizike, kjo rrethanë do të duhej të pasqyrohej në mënyrë të qartë në ofertën elektronike, në përputhje me **Nenin 32.5 të**

**Rregullores së Prokurimit Publik**, i cili përcakton se:

*“Tenderët mund të shoqërohen me dokumente në formë fizike, si: mostrat, katalogjet dhe çfarëdo dëshmie tjetër e cila nuk mund të ngarkohet përmes sistemit elektronik të prokurimit, mirëpo gjatë hartimit të ofertës elektronike operatorët ekonomik duhet t'i specifikojnë dokumentet të cilat dërgohen në formë fizike.”*

Në rastin konkret, mungesa e specifikimit të këtyre dokumenteve në formularin elektronik përbën shkelje të kësaj dispozite, duke e bërë të pamundur verifikimin e rregullsisë së dorëzimit të tyre.

Deshmia:



## **Pretendimi 6 – Shkelje e Nenit 10 të LPP-së (Transparenca dhe qasja në dokumentacion)**

Kemi kërkuar qasje në dokumentacionin e plotë të ofertës së Operatorit Ekonomik të propozuar për kontratë, si dhe në Raportin e Komisionit të Vlerësimit, i cili përbën dokumentin bazë mbi të cilin Autoriteti Kontraktues ka marrë vendimin për rekomandim të kontratës.

Autoriteti Kontraktues (AK) e ka aprovuar kërkesën dhe ka ofruar qasje në ofertën e OE të propozuar. Megjithatë, nuk është vënë në dispozicion Raporti i Komisionit të Vlerësimit, i cili është pjesë thelbësore e dosjes së vlerësimit dhe vendimmarrjes.

Në veçanti, mungesa e Raportit të Komisionit të Vlerësimit pamundëson verifikimin e mënyrës se si është bërë vlerësimi i ofertës së OE të propozuar si i përgjegjshëm, si dhe **momentin dhe mënyrën se kur janë dorëzuar dhe marrë për bazë dokumentet thelbësore si certifikata ISO 9001:2015 dhe katalogu i produkteve.**

Kjo është me rëndësi thelbësore, pasi këto dokumente përbëjnë elemente materiale të përmbushjes së kërkesave të Dosjes së Tenderit dhe ndikojnë drejtpërdrejt në vendimin për kualifikimin apo eliminimin e operatorit ekonomik.

Pa Raportin e Komisionit të Vlerësimit nuk mund të konstatohet:

- nëse OE është vlerësuar në mënyrë të drejtë si i përgjegjshëm,
- nëse dokumentet (ISO dhe katalogu) kanë qenë pjesë e ofertës në momentin e dorëzimit apo janë marrë parasysh në mënyrë të mëvonshme, dhe
- nëse vlerësimi është bërë në përputhje me kërkesat obligative të Dosjes së Tenderit dhe dispozitat e LPP-së.

Rrjedhimisht, kjo mungesë cenon drejtpërdrejt parimin e transparencës të garantuar me Nenin 10 të LPP-së dhe pamundëson kontrollin efektiv të ligjshmërisë së vendimit të Autoritetit Kontraktues.

### **Pretendimi 7 – Shkelje e Nenit 61 dhe 63 të Rregullores së Prokurimit publik**

Trepqa SH.A. ka shkelur dispozitat e mëposhtme të Rregullores së Prokurimit Publik:

- **Neni 61.3** përcakton “*Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, do të publikojë Kërkesën për rishqyrtim në Platformë tek dosja e tenderit në “shtu dokument shtesë” dhe do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e parashtrimit të kërkesës*”
- **Neni 63.2** përcakton “*Vendimi mbi refuzimin ose miratimin është obligativ dhe do të publikohet në sistem të prokurimit elektronik si “Dokument shtesë” tek dosja e tenderit nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit*”.

Në rastin konkret, Trepqa SH.A. **nuk ka respektuar këto dispozita**, pasi nuk ka:

1. Nuk ka publikuar vendimin për pezullim të procedurës pas parashtrimit të kërkesës për rishqyrtim;
2. Nuk ka publikuar kërkesën për rishqyrtim në Platformë;
3. Nuk ka publikuar vendimin e Autoritetit Kontraktues mbi refuzimin e kërkesës.


Në lidhje me këtë, nga AK Trepqa SH.A kërkojmë që të merr këtë:

### **Pretendimi 8 – Shkelje e Nenit 72 të LPP-së (kërkim i kundërligjshëm i dokumenteve materiale pas afatit të ofertimit)**

Nga përgjigja e Autoritetit Kontraktues në shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim rezulton qartë se AK ka kërkuar dhe pranuar dokumente shtesë nga OE i propozuar për kontratë gjatë fazës së vlerësimit, konkretisht certifikatën ISO 9001:2015 dhe katalogun e produkteve.

Vetë fakti se AK në përgjigjen e saj deklaron se: “**OE fitues i kontratës ka dorëzuar sqarimet e nevojshme pas kërkesës për sqarim të tenderit**” vërteton se dokumentet materiale mbi të cilat është bazuar vlerësimi nuk kanë qenë pjesë e ofertës së dorëzuar në momentin e ofertimit. Në rastin konkret, AK është thirrur në mënyrë të gabuar në Nenin 72 të

## LPP-së. Sipas Nenit 10 të Udhëzuesit për Prokurim Publik “sqarimi i tendereve”:



The screenshot shows a Microsoft Word document with the following table:

| UDHËZUES NR. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT NR. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK |   |    |
|--|---|----|
| deklaratën ku deklaron se mallrat do të jene ne përputhje me specifikimin e kërkuar)           |   |    |
| Është dorëzuar specifikacioni teknike për mallrat e ofruara por mungon katalogu                | Mund të kërkohen informata sqaruese                 | 69 |
| Është dorëzuar katalogu por mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara                 | Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm | 69 |
| Është kërkuar autorizimi original por është dorëzuar autorizimi i skanuar                      | Mund të kërkohen informata sqaruese                 | 66 |

Sipas Nenit 10 të Udhëzuesit për Prokurim Publik, katalogu mund të kërkohet vetëm në rastet **kur operatori ekonomik ka dorëzuar paraprakisht specifikacionin teknik** të mallrave të ofruara dhe mungon vetëm katalogu si dokument mbështetës.

Mirëpo, në rastin konkret, OE **nuk ka dorëzuar as specifikacionin teknik dhe as katalogun e produkteve në momentin e ofertimit**. Rrjedhimisht, AK nuk ka pasur të drejtë ligjore të kërkojë dokumente shtesë për të plotësuar ofertën, pasi nuk kemi të bëjmë me sqarim të një dokumenti ekzistues, por me mungesë totale të dokumentacionit material të kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Gjithashtu, certifikata ISO 9001:2015 nuk është dokument administrativ i OE-së, por **dokument material që lidhet drejtpërdrejt me prodhuesin e mallrave të ofruara** dhe me përmbushjen e kërkesave obligative të Dosjes së Tenderit. Si e tillë, ajo është dashur të jetë pjesë integrale e ofertës në momentin e dorëzimit dhe nuk ka mundur të kërkohet apo të pranohet pas afatit të ofertimit.

Pranimi i dokumenteve materiale pas afatit të ofertimit:

- cenon integritetin e procedurës së prokurimit;
- krijon avantazh të padrejtë për OE të propozuar;
- cenon parimin e trajtimit të barabartë sipas Nenit 7 të LPP-së; dhe
- përbën ndryshim material të ofertës pas hapjes së tenderëve.

Rrjedhimisht, veprimet e Autoritetit Kontraktues janë në kundërshtim me Nenin 72 të LPP-së dhe oferta e OE të propozuar është dashur të shpallet e papërgjegjshme dhe të eliminohet nga procedura e mëtejme e vlerësimit.

## **Pretendimi 9 – Mosshqyrtimi dhe mosarsyetimi i pretendimeve ankimore (shkelje e Nenit 108/A të LPP-së dhe parimit të arsyetimit të vendimeve administrative)**

Autoriteti Kontraktues gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim nuk ka trajtuar në mënyrë konkrete dhe të arsyetuar asnjërin nga pretendimet e paraqitura në ankesë.

Kemi paraqitur gjithsej gjashtë (6) pretendime të detajuara, të mbështetura me referenca konkrete ligjore, prova dokumentare, specifikime teknike, dhe argumentim juridik.

Megjithatë, përgjigja e AK-së përmban vetëm konstatime të përgjithshme dhe deklarative, si:

“OE fitues i kontratës ka dorëzuar sqarimet e nevojshme pas kërkesës për sqarim të tenderit” dhe “Vlerësimi i ofertave është bërë në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe në përputhje me kriteret e dosjes së tenderit”.

AK nuk ka dhënë asnjë arsyetim konkret lidhur me:

- mungesën e katalogut në formularin e dorëzimit të ofertës,
- mungesën e certifikatës ISO në listën e dokumenteve të dorëzuara,
- skadimin e certifikatës ISO,
- mospërputhjet teknike të artikujve të ofruar,
- mungesën e raportit të komisionit të vlerësimit,
- aplikimin e Nenit 72 të LPP-së,
- si dhe mungesën e evidencës që dokumentet kanë ekzistuar para afatit të ofertimit.

Pra, AK nuk ka bërë shqyrtim real të pretendimeve, por vetëm ka refuzuar kërkesën në mënyrë formale.

Një vendim i tillë cenon të drejtën për mjet juridik efektiv, pamundëson kontrollin e ligjshmërisë së vendimit, dhe bie ndesh me parimet e transparencës dhe arsyetimit të vendimeve administrative.

Autoriteti Kontraktues ka obligim ligjor që për secilin pretendim të japë:

- trajtim individual,
- analizë konkrete,
- dhe arsyetim juridik e faktik.

Mosadresimi i pretendimeve përbën në vetvete shkelje procedurale që e bën vendimin e AK-së të paarsyetuar dhe të kundërligjshëm.

### **V E N D I M**

**I. APROVOHET, si e bazuar,** Ankesa e operatorit ekonomik “GETNO L.L.C”, e paraqitur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Furnizim me rrypa trapezor**”, me Nr. të prokurimit: **2026/12997 12998-26-1205-1-2-1/B05-0004051.**

**II. ANULOHET** Njoftimi i Autoritetit Kontraktues (B58), i datës 14.05.2026, ndërsa

aktiviteti i prokurimit me titull **Furnizim me rrypa trapezor**”, me Nr. të prokurimit: **2026/12997 12998-26-1205-1-2-1/B05-0004051**, kthehet në rivlerësim.

**IV. Pas përfundimit të procesit të rivlerësimit**, Autoriteti Kontraktues **të shpallë fitues Operatorin Ekonomik “GETNO L.L.C”**

## **9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, duke shperblyer me oferte OE te papergjegjshem, gjë që ka shkaktuar pasoja të drejtpërdrejta materiale, përfshirë:

1. Kostot e përgatitjes së ofertës dhe dokumentacionit mbështetës;
2. Dëmin ekonomik të shkaktuar nga humbja e një kontrate të mundshme;
3. Pengesën në realizimin e investimeve të planifikuara për këtë aktivitet

## **10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

1. *një kopje e Njoftimit mbi kontrate*
2. *një kopje e Njoftimit mbi Vendimin e AK*
3. *nje kopje e Kerkeses per rishqyrtim*
4. *një kopje te vendimit te AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se*
5. *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*